



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr.1799/5 prot.

Tiranë më 17.11.2022

VENDIM

Nr. 48, datë 17.11.2022

PËR KONTROLLUESIN “SHKOLLA RREZE DRITE”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Shkolla Rreze Drite” (në vijim, “Kontrolluesi”).

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 184, datë 19.10.2022 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisionerit”), u krye hetim administrativ pranë Kontrolluesit me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, me fokus të veçantë informimin dhe pëlqimin gjatë përpunimit të dhënave personale.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi (*Shkolla Rreze Drite*), është institucion arsimor jopublik, i regjistruar nën emër të Fondacionit Kazazi, themeluar me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe ushtron aktivitetin për këto nivele arsimore: Arsimi parashkollor, Arsimi bazë dhe Arsimi i mesëm i lartë.

Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë “nxënës”, “prindër”, “staf akademik”, “punonjës”, “vizitorë” etj.

2. Kontrolluesi administron dokumentacionin e grumbulluar për stafin akademik si dhe nxënës në arkivën fizike, pranë Zyrës së Sekretarisë. Në dokumentacionin e grumbulluar nga Kontrolluesi gjenden edhe dosje të mësuesve të larguar dhe që nuk ushtrojnë më asnjë detyrë, pranë shkollës "Rreze Drite". Gjithashtu, në arkivën fizike konstatohen edhe dosje me CV të subjekteve të të dhënave që prej vitit 2011 e në vazhdim, të cilët kanë aplikuar për pozicione të lira pune.

Kontrolluesi gjatë këtyre proceseve përpunuese, nuk ka respektuar parimin e mbrojtjes së të dhënave personale lidhur me kohën e ruajtjes së të dhënave personale. Të gjitha të dhënat e mbledhura nga Kontrolluesi në funksion të ushtrimit të aktivitetit të tij ruhen kryesisht që nga koha e grumbullimit të këtyre të dhënave, pa përcaktuar një afat konkret të ruajtjes së tyre, në kundërshtim me germën “d” të pikës 1, të nenin 5 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me kategoritë e të dhënave të grumbulluara nga Kontrolluesi në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij, si “dosje të mësuesve të larguar”, “CV të aplikantëve për punë”, duhet të parashikojë ruajtjen e të dhënave personale të grumbulluara në atë formë, që lejon identifikimin për një kohë të caktuar, por jo më tepër sesa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin e grumbullimit. Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimet ligjore specifike dhe qëllimin e grumbullimit të informacionit.

3. Nga verifikimi rezulton se Kontrolluesi administron në platformën “Facebook” dhe “Instagram” një profil zyrtar të shkollës, në të cilin pasqyrohen aktivitetet e zhvilluara, duke i ilustruar/publikuar nëpërmjet fotografive dhe videove të fëmijëve të shkollës, të marra gjatë aktiviteteve mësimore, kulturore, festa, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga Kontrolluesi për nxënësit e shkollës, rezulton se përpara regjistrimit të çdo nxënësi, prindi duhet të plotësojë një “Formular Aplikimi për regjistrimin e nxënësve Klasa _ Viti shkollor_”. Në këtë formular prindi i cili regjistron fëmijën pranë kësaj shkolle, duhet të pasqyrojë të dhënat sipas rubrikave të formularit.

Në këtë formular rezulton se ka një “Klauzolë Deklarative” ku prindi ka mundësinë të jap ose jo pëlqimin për përpunimin e të dhënave të tij personale për qëllime statistikore, të shqyrtimit të aplikimit si dhe për zhvillimin e sondazheve të automatizuara, por nuk rezulton që nga Kontrolluesi të praktikohet marrja e pëlqimit me shkrim, të prindit të subjektit të të dhënave minoren, për publikimin e fotografive të nxënësve në platformat “Facebook” dhe “Instagram” në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe kriteret ligjore për përpunimin e të dhënave

të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 4, datë 16.03.2010 të Komisionerit për “Marrjen e masave të sigurisë së të dhënave personale në veprimtarinë e fushës së arsimit” (në vijim, “Udhëzimi nr. 4”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, përpunimi i të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, përmes publikimit të fotografive të nxënësve në platformat “Facebook” dhe “Instagram” në rastin konkret, pa marrë paraprakisht “Pëlqimin” me shkrim të prindit ose kujdestarit ligjor, bie në kundërshtim me nenet 5 dhe 6 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 4.

“Pëlqimi” referuar përkufizimit të parashikuar në pikën 24, të nenit 3 të Ligjit duhet në formë shkresore, i dhënë shprehimisht, me vullnet të plotë e të lirë dhe duke qenë në dijeni të plotë për arsyen pse të dhënat do të përpunohen. Ekzistenca e pëlqimit në këtë rast është e vetmja mundësi ligjore e Kontrolluesit, referuar pikës 5 të nenit 6 të Ligjit, për të legjitimuar përpunimin e të dhënave personale.

4. Kontrolluesi disponon faqen online www.shkollarrezedrite.com. Konstatohet se, në këtë faqe nuk ka të publikuar rubrikën “Politikat e Privatësisë”, me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave personale, mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave, personin që do t’i përpunojë, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave, nëse dhënia e të dhënave personale është e detyrueshme apo vullnetare, si dhe të drejtën për të kundërshtuar përpunimin e mëtejshëm të tyre, në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Gjithashtu, Kontrolluesi në këtë faqe, ka edhe një rubrikë përmes së cilës pranon aplikime të hapura për punë, të kandidatëve të ndryshëm të cilët kanë mundësi të hedhin të dhënat e tyre personale (emër, mbiemër, nr. telefoni, email, CV), me qëllim aplikimin për punësim pranë Kontrolluesit. Konstatohet se dhe përmes kësaj rubrike për aplikim për punë nuk realizohet informimi i subjekteve të të dhënave të cilët aplikojnë për punë sipas parashikimeve të nenit 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se çdo Kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes zyrtare, ka detyrimin që të publikojë “Politikat e Privatësisë”, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash me Kontrolluesin realizohet nëpërmjet faqes online të internetit.

Informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërbushja e këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit mund të sjellë pasoja sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

Në këtë kuadër, publikimi i rubrikës “Politikat e Privatësisë” në faqen zyrtare të Kontrolluesit përmbush qëllimin e informimit përkundrejt subjekteve të të dhënave të

cilët aksesojnë dhe ngarkojnë të dhëna personale në faqe. Njëkohësisht, informimi sipas përcaktimeve të nenit 18 të Ligjit, duhet të aplikohet për çdo proces përpunimi të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave (*të tilla si: aplikime të hapura për punë përmes faqes*).

5. Kontrolluesi disponon një sistem të video-survejjimit (CCTV) për mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të institucionit, për qëllim të sigurisë së personelit, nxënësve dhe pronës. Grupi i hetimit ka konstatuar se, nuk janë vendosur tabela informuese mbi prezencën e sistemit të video-survejjimit (CCTV), në kundërshtim me parashikimin e nenit 18 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 3, datë 05.03.2010 të Komisionerit *“Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video-survejjimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”* i ndryshuar (në vijim, *“Udhëzimi nr. 3”*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të video-survejjimit (CCTV) është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë.

Sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 3, subjektet e të dhënave duhet të informohen qartësisht që një sistem video regjistrimi është në veprim, duke vendosur njoftimin e shkruar në hapësirën e monitoruar. Gjithashtu, Kontrolluesi detyrohet të vendosë në ambientet e survejuara modelin standard të tabelës informuese për mbikëqyrjen me sistemin e survejjimit të miratuar nga Komisioneri.

6. Kontrolluesi për sistemin e video-survejjimit (CCTV) që disponon ka lidhur një kontratë me shoqërinë *“OKTAPUS 1 SECURITY SHPK”* SH.P.S.F, me objekt marrjen në ruajtje dhe sigurimin e objektit. Nga verifikimi i kësaj kontrate me palën e tretë, rezulton se nuk janë reflektuar detyrimet sipas parashikimeve në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit *“Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”* i ndryshuar (në vijim, *Udhëzimi nr. 19*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave Kontrolluesi duhet të miratojë një kontratë, që palët duhet të përdorin në rast të këtij delegimi, me anë të së cilës të garantojë përcaktimin e rregullave në marrëdhënien e tij me përpunuesin, me qëllim që delegimi i përpunimit të këtyre të dhënave të përpunuesit të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe/ose shërbimit, Kontrolluesi duhet të sigurohet që përpunuesi të garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave. Detyrimet e përpunuesit për përpunim të ligjshëm të të dhënave personale,

parashikohen në nenin 20 të Ligjit dhe rregullohen me aplikimin e parashikimeve të Udhëzimit nr. 19.

Sipas përcaktimeve të Udhëzimit të sipërcituar, çdo kontratë përpunimi (*outsourcing*) që ka për qëllim përpunimin e të dhënave personale duhet të përmbajë dispozita që vendosin rregulla për përpunimin e të dhënave personale sipas legjislacionit shqiptar. Çdo kontratë e tillë duhet të parashikojë çdo masë që merr përpunuesi për të siguruar mbrojtjen e mjaftueshme të të dhënave, si dhe hapat që do të ndërmerren në rast cenimi të të dhënave.

7. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, në protokollin e Zyrës së Komisionerit, rezulton se Kontrolluesi ka njoftuar mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës. Gjatë hetimit administrativ të ushtruar, është konstatuar se “*Njoftimi*” ka mangësi në deklarin, sa i përket rubrikave të formularit si vijon:

- Deklarimin në rubrikën 1.1, të formularit të njoftimit “*Të dhënat e subjektit kontrollues*”;
- Deklarimin në rubrikën 1.2, të formularit të njoftimit “*Personi i kontaktit ngarkuar nga subjekti*”;
- Deklarimin në rubrikën 3.1, të formularit të njoftimit “*Kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen*”;
- Deklarimi në rubrikën 4.1, të formularit të njoftimit “*Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen*”;
- Deklarimi në rubrikën 5.1, të formularit të njoftimit “*Të dhënat sensitive që përpunohen*”;
- Deklarimi në rubrikën 6.1, të formularit të njoftimit “*Qëllimi i përpunimit*”;
- Deklarimin në rubrikën 7.1, të formularit të njoftimit “*Marrësi i të dhënave personale*”.

Konstatimet e mësipërme janë në kundërshtim me parashikimet e neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për përditësimin e ndryshimit të gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave sipas parashikimeve të nenit 21 dhe 22 të Ligjit është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep Ligji.

8. Kontrolluesi nuk ka hartuar “*Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*” në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike (*mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale për çdo kategori subjekti të dhënash*) sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e

mbajtjes së të dhënave, masat teknike dhe organizative etj., si dhe nuk ka nënshkruar deklaratë konfidencialiteti më punëmarrësit, në kundërshtim me nenin 27 dhe 28 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një “*Rregulloreje specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47, datë 14.09.2018 të Komisionerit “*Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha*”, (në vijim, “*Udhëzimi nr. 47*”), duke mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

9. Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale lidhur me legjislacionin shqiptar në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas parashikimeve të Kreut IV të Udhëzimit nr. 47.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, natyrës së veprimtarisë që ushtron, si dhe për shkak të kategorive të të dhënave personale që përpunon, kërkohen masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale.

Sipas parashikimeve të Kreut IV të Udhëzimit nr. 47, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky është një detyrim i vazhdueshëm i Kontrolluesit që personeli i subjektit përpunues të të dhënave personale të trajnohet rregullisht për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vendosur në dispozicion Kontrolluesit përmes postës zyrtare.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i Kontrolluesit ka bërë me dije se po merr masa për rikuperimin e disa prej shkeljeve të konstatuara në përfundim të hetimit administrativ, si dhe ka deklaruar angazhimin në vijim, për rikuperimin e shkeljeve të tjera, duke paraqitur:

- Tabela informuese mbi prezencën e sistemit të video-survejjimit (CCTV);
- Deklaratë personale të prindërve për dhënien e pëlqimit për publikimin e fotografive të fëmijëve në platformat “Facebook” dhe “Instagram”;
- Deklaratë mbi përcaktimin e afatit për ruajtjen e dokumentacionit “CV të mësuesve”;
- Deklaratë mbi qëllimin e përdorimit të kamerave;
- Deklaratë personale të prindërve për dhënien e pëlqimit për monitorimin me kamera të ambienteve si oborr, korridore, klasa.

Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit administrativ dhe angazhimin e tij për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara, megjithatë kjo nuk e përjashton atë nga përgjegjësia administrative në rastin konkret, për shkak se detyrimet duhet të ishin plotësuar paraprakisht nga Kontrolluesi, në përmbushje të detyrimeve të ligjit. Gjithashtu, masat e marra prej Kontrolluesit nuk janë të plota sipas konstatimeve të procesverbalit të inspektimit. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm, pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe eviton mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

Në përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuptim të germave “a”, “b”, “ç”, “d” dhe “dh” të pikës 1 të nenit 39 të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

- a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II “Përpunimi i të dhënave personale”, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;
- b) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;
- ç) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;
- d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;
- dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë;

Në bazë të pikës 2 të nenit 39 të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka mbajtur parasysh faktin që, shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave. Gjithashtu, Zyra e Komisionarit, ka vlerësuar mënyrën e reagimit të Kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara, bashkëpunimin e tij me grupin e hetimit administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 18, 20, 21, 27, 28, 29, 30, 39 pika 1, germat “a”, “b”, “ç”, “d” dhe “dh”, si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

V E N D O S A:

- 1- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 40 000 (dyzetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në Kreun II të Ligjit;
- 2- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 18 të Ligjit;
- 3- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 20 të Ligjit;
- 4- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenet 27 dhe 28 të Ligjit;
- 5- Kontrolluesi, të marrë masa për përpunimin e të dhënave personale në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të sanksionuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit;
- 6- Kontrolluesi të marrë masa që të rishikojë çdo proces përpunimi të të dhënave personale, për përcaktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, për të gjitha proceset e përpunimit, në përputhje me germën “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit;
- 7- Kontrolluesi, të marrë masa për përpunimin e të dhënave personale në përputhje me dispozitat e parashikuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit, duke përdorur sfumatuara në fotografitë dhe videot e nxënësve (fëmijë-minoren), të publikuara në rrjetet sociale, ose duke marrë pëlqimin me shkrim të prindit të të miturit apo personit i cili gëzon përgjegjësinë prindërore, për publikimin e të dhënave të tyre, sipas parashikimit të pikës 24, të nenit 3 të Ligjit;
- 8- Kontrolluesi, të marrë masa për zbatimin e detyrimeve sipas parashikimeve të nenit 18 të Ligjit, në lidhje me informimin e subjekteve të të dhënave;
- 9- Kontrolluesi, të marrë masa për të rishikuar marrëveshjet e bashkëpunimit me përpunuesit duke specifikuar detyrimet midis palëve, dhe të monitorojë në vijimësi zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në marrëveshjet me përpunuesit, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit;

- 10-** Kontrolluesi, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, të ketë në vëmendje përditësimin e “Njoftimit” në lidhje me ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave personale, të cilat përpunon;
- 11-** Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 dhe 28 të Ligjit, të marrë masa për hartimin e rregullores “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, duke parashikuar masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, garantimin e konfidencialitetit etj., në funksion të aktivitetit të tij, për çdo proces përpunimi;
- 12-** Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e stafit të tij;
- 13-** Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
- i. vazhdimisht, detyrimet e treguara në pikën 5 më sipër;
 - ii. brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikat 6, 7, 8, 9 dhe 10 më sipër;
 - iii. brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikën 11 më sipër;
 - iv. brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikën 12 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes në dijeni të këtij akti;

- 14-** Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra;
- 15-** Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbartimit;
- 16-** Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 17.11.2022.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi